



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:229300

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05541362

C.nr. 24/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.S nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson me autorizim Av. F.B nga Vushtrria, kundër të paditurës B... me seli në Prishtinë, rruga .., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seance me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr. 24/18 e datës 22.01.2018, e paditësit F.S nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës B... me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore-kompensim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësi F.S nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, përmes të autorizuarës së tij, me datë 22.01.2018, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës B... me seli në Prishtinë, rruga ...

E autorizuara e paditësit, me parashtrësën e datës 03.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj nga kjo arsye e tërheqë padinë në këtë çështje kontestimore.

Gjykata, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr. 24/18, me datë 03.04.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.